

**"Hib Petrol" sh.p.k. Ferizaj**

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**  
**Për stacionin e karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k.**  
**Preoc, Graçanicë**

**Janar, 2025**

**"Hib Petrol" sh.p.k. Ferizaj**

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**  
**Për stacionin e karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k.**  
**Preoc, Graçanicë**

**Hartues i VNM-së:**

**Dr.sc. Raif Bytyçi, inxhi. i mjedisit, person fizik i licencuar**

---

**"Aplikon për Pëlqim Mjedisor:**  
**"Hib Petrol" sh.p.k.**

**Janar, 2025**

# PËMBAJTJA

1. HYRJE.....	5
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT.....	6
2.1 Rregullativa ligjore.....	6
2.2. Metodologjia e punës.....	8
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT.....	9
3.1. Potencialet ekzistuese .....	9
3.2. Pozita gjeografike e lokacionit.....	9
3.3. Popullsia dhe vendbanimet .....	13
3.4. Infrastruktura ekzistuese .....	14
3.5. Kushtet klimatike.....	14
3.6. Gjendja hidrologjike.....	14
3.7. Flora dhe fauna .....	15
3.8. Peizazhi .....	16
3.9. Ajri .....	16
3.10. Ujerat .....	17
4. PËRSHKRIMI I KOMPLEKSIT TË STACIONIT .....	17
4.1. Përshkrimi i pajimeve dhe objekteve ndërtimore .....	17
4.2. Objekti tjera dhe infrastruktura përcjellëse .....	20
4.3. Platoja e kompleksit .....	21
4.4. Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta - naftë dhe benzinë .....	22
4.5. Rezervari për karburant të gaztë në gjendje të lëngësuar (propan-butan) .....	23
4.6. Karakteristikat e procesit ne stacionin e karburanteve .....	23
4.7. Komponentët hyrëse në procesin teknologjik .....	24
4.8. Komponentët dalëse në procesin teknologjik .....	25
4.9. Alternativat e projektit.....	25
5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS .....	26
5.1 Ndotja e tokës .....	26
5.2. Ndotja e ujit .....	27
5.3. Ndotja e ajri .....	27

5.4. Zhurma .....	28
5.5. Ndikimet në florë dhe faunë .....	28
5.6. Ndikimi ne mjedis nga mbeturinat dhe menaxhimi i yure .....	28
5.7. Përshkrimi i pasojave të mundshme mjedisore të projektit .....	29
5.7.1. Rreziqet e mundshme ne mjedis - shëndet nga fatkeqësitë ose katarstrofat .....	30
5.7.2. Ndikimet e mundshme në trashëgiminë kulturore .....	30
6. VËLERSIMI I RREZIKIMIT TË MJEDISIT NGA AKSIDENTET .....	31
6.1.1. Analiza e trungut të ngjarjeve .....	34
6.1.2. Mundësitë e ndikimeve nga rezervarët .....	34
6.1.3. Aksidenti në pjesë të rezervarit (vrima në rezervar) .....	35
6.1.4. Aksidenti në sistemin shpërndarës .....	35
6.2. Analiza e pasojave .....	36
6.2.1. BLEVE .....	36
6.2. 2. VCE .....	36
6.2. 3. Zjarri në rezervar .....	37
6.3 Vlerësimi i rrezikut .....	37
6.3.1. Vlerësimi i gjasave të ndodhjes së aksidentit .....	38
6.3.2. Vlerësimi i pasojave të mundshme .....	38
7. MASAT E MBROJTËS SË MJEDISIT .....	39
7.1. Masat mbrojtëse të ujërave .....	39
7.2. Masat mbrojtëse në rezervar .....	41
7.3. Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës .....	42
7.4. Rekomandimet tjera për evitimin e rrezikut .....	42
8.0. Masat për rehabilitimin e mjedisit .....	43
9. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE .....	43
9.1. Përshkrimi i shkurt i procesit .....	43
9.2. Ndikimet ne mjedis .....	44
9.3. Masat mjedisore .....	46
10. Përfundime .....	48

## 1. HYRJE

Për hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të stacionit të karburanteve dhe atë për lëndë djegëse të lëngëta dhe të gazta, nevojitet të bëhet analizë e ndikimeve të mundshme në mjedis të stacionit për deponimin dhe shitjen e karburanteve të lëngëta dhe të gazta- stacioni i karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të nevojshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, dhe pastaj për marrjen e lejes mjedisore dhe operimin e stacionit të karburanteve.

Përmes këtij raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mundë të paraqiten në relacionin stacioni i karburanteve dhe mjedisi jetësor duke marrë parasysh mjedisin e gjerë.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis i stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse me të gjitha veprimtarit punuese (shërbim, transport, deponim, trajtimi i materieve të rrezikshme etj.), në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për stacionin e karburanteve të kompanisë "Hib Petrol" sh.p.k. në lokacionin Preoc, Graçanicë, është punuar, duke u bazuar në projektin e ndërtimit, gjendjen aktuale të objektit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku është ndërtuar stacioni i karburanteve si dhe dokumentit teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-s të stacionit të karburanteve kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjer në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së aktiviteteve të punës të stacionit të karburanteve dhe pas përfundimit të aktivitetit të punës të stacionit të karburanteve, ndërsa për fazën e ndërtimit të stacionit të karburanteve do të merren për bazë ndikimet evidente në këtë procesin e funksionimit të stacionit të karburanteve në "Hib Petrol" sh.p.k. në Preoc, Graçanicë.

## **2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT**

VNM është hartuar ne baze te Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis Nr. 08/l-181 (2023), i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së, i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM -së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis ka për qellim për te siguruar mundësimin e një vlerësimi te përgjithshëm me ndërthurje te ndikimeve mjedisore te projekteve apo veprimtarive qe do te realizohen me qellim qe te parandalojnë dhe te zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative ne mjedis ne kohen e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve edhe at :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjer në kufijtë e lejuar.

### **2.1 Rregullativa ligjore**

#### **a) Dokumentacioni normativ**

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM -së për stacionin e karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. në Preoc, Graçanicë janë marrë për bazë ligjet me te rëndësishme te aplikuar qe do të shënohen me poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023)
- Ligji për Vlerësimin Strategjike Mjedis, Nr.03/L-230)
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022)
- Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233

- Ligji nr.08/l-275 për rrugët, Ndryshim - Plotësim i Ligji nr. 2003/11 Ligji për rrugët , shfuqizim i ligji nr.03/l-120 për ndryshimin dhe plotësimin (Nëntor 2024),
- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligjit Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L- 89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë .
- Ligji nr. 02/L-78 Ligji për Shëndetësi Publike.
- Ligji nr. 08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.
- Udhëzim administrativ Nr 04 /2022 për Lejes Mjedisore
- Udhëzim administrativ Nr 01 /2017 për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.
- Udhëzim administrativ nr. 18 /2024 për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje mjedisore të integruar.
- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.
- Udhëzim administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (QRK) – NR. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ MMPH,Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave,produktet medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës
- Udhëzimi administrativ Nr.05/13. për menaxhimin e vajrave të përdorura.

#### **b) Dokumentacioni teknik**

- Projekti i ndërtimit të stacionit të karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. në Preoc, Graçanicë me objektet përcjellëse
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit të ngastrës
- Plani i situacionit.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse si që është direktiva e VNM-së (85/337/EEC).

## **2.2. Metodologjia e punës**

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për stacionin e karburanteve me objektet përcjellëse, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë:

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të

- njeriut
- vlerave materiale
- vlerave natyrore.

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve. Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet vlerësimin të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.



### **3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT**

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM -së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

#### **3.1. Potencialet ekzistuese**

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të stacionit të karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyrorë si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.

Çdonjëra nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësisë të mbrojtjes së mjedisit. Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme. Në bazë të raporteve relevante mjedisore është e qartë që faktorët natyrorë formojnë disa potenciale natyrore karakteristika funksionale të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit në mjedis të stacionit të karburanteve të ndërtuar në hapësirën e lartcekur.

#### **3.2. Pozita gjeografike e lokacionit dhe objektet**

Lokacioni i stacionit të karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. në Preoc, Graçanicë, konkretisht në anën e djathtë të rrugës Prishtinë - Ferizaj. Stacioni i karburanteve me objektet

përcjellëse është i ndërtuar në njësinë kadastrale P-73414058-00697-1, në zonën kadastrale Preoc, komuna Graçanicë. Figura 1, lokacioni i stacionit të karburanteve.



Fig. 1. Lokacioni i stacionit të karburanteve në Preoc, Graçanicë, është zonë e përshtatshme për ushtrim të këtij aktiviteti, për shkak të pozitës gjeografike që ndodhet.



Figura 2. Pamjet e stacionit të karburanteve Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë

Përshkrimi i lokacionit në afërsi të drejtpërdrejt të ngastrës ku është i ndërtuar stacioni i karburanteve:

Ngastra e stacionit të karburanteve Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë, gjendet në anën e djathtë të rrugës magjistrale Preshtinë - Ferizaj, shih figurën 1 (lokacioni i stacionit të karburanteve) dhe figurën 2 (pamjen e stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse. Objektet e stacionit të karburanteve (që trajton kjo VNM) – rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit, pompat për furnizim me karburant, streha e stacioneve të pompave, objekti i administratës, marketi, restoranti, tualeti, tërasi, këndi i lodrave për fëmijë, bodrumi, i cili shërben si depo për destinime përkatëse dhe gardëroba për punëtorëve.

Lokacioni i stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse, gjendet në zone tipike industriale- biznesore dhe kufizohet si në vijim:

**Në veri** të Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë parcela kufizohet me objekte biznesore dhe objekti me afërt gjendet në distancë rreth 100 m , përtej sajë hapësira të lire dhe tutje objekte tjera biznesore. Pamjet në figurën 3, në vijim.



Figura 3. Pamjet veri të stacionit të karburanteve

Në lindje të Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë, parcela kufizohet me rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj, ku ka qasjen stacioni i karburanteve dhe përtej saje objekte biznesore – afariste. Pamjet në figurën 4.



Figura 4. Pamjet në lindje të stacionit të karburanteve



Figura 5. Pamjet në jug të stacionit të karburanteve

**Në jug** të Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë parcela kufizohet me rrugën lokale qe te shpie te Hotel Emaerald dhe përtej sajë me objekte afariste-biznesore, te cilat gjenden ne distance rreth 100 Përtej sajë gjenden objekte tjera afariste dhe hapësira te lira. Pamjet ne figurën 6.

**Në perëndim** të Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë parcela kufizohet me parcelën tjetër me pronar te njëjtë me këtë te stacionit te karburanteve, përkatësisht me objektin e Hotel Emerald, i cili gjendet ne distance rreth 60 metra nga vija kufizuese e parcelës dhe rreth 100 metra nga objekti i stacionit te karburanteve. Pamjet në figurën 6, ne vijim.



Figura 6. Pamjet në perëndim të stacionit të karburanteve

Në bazë të këtij përshkrimi të gjendjes dhe gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme në mjedis, gjatë punës së stacionit të karburanteve.

### **3.3. Popullata dhe vendbanimet**

Një rëndësi te veçantë në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në

hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme mjedisore negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar. Bazuar në të dhënat ekzistuese dhe në bazë të vlerësimeve në Komunën së Graçanicës jetojnë rreth 25,000 banorë. Në Komunën së Graçanicës gjenden rreth 4.500 ekonomi familjare. Por si dhe në gjithë territorin e Kosovës dhe me gjere, edhe në këtë komune, po ndodhin lëvizje dinamike të banorëve, sidomos të grup moshave të reje, si migrime për qëllime ekonomike dhe lëvizje tjera. Andaj të dhënat për popullsinë duhet marruar me rezerve.

### **3.4. Infrastruktura ekzistuese**

Në afërsi të lokacionit - infrastruktura rrugore është e rregulluar në afërsi ku kalon magjistranja Prishtinë - Ferizaj, e cila mundëson lidhje të Prishtinës me Lipjanin dhe Ferizajn. Objekti i stacionit të karburanteve, me objektet përcjellëse (që i trajton ky Raport i VNM-së) është me qasje të plote në rrugën magjistrale me pozite shumë të volitshme, si në aspektin ekonomik edhe atë mjedisor e të sigurisë. Gjithashtu infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe aspekteve tjera është e rregulluar mjaftë mirë.

### **3.5. Kushtet klimatike**

Klima në komunën e Graçanicës është kryesisht klimë kontinentale, që karakterizohet nga vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë, me ndikime të klimës së Mesdheut dhe të Alpeve (temperatura mesatare sillet nga plus 30 °C gjatë verës deri në minus -10 °C gjatë dimrit). Dhjetori dhe janari janë muajt më të ftohtë dhe korriku e gushti janë më të ngrohtë. Volumi maksimal i reshjeve të shiut është në muajt tetor dhe dhjetor, reshje totale vjetore shiu rreth 600 mm për m<sup>2</sup>. Dëbora në përgjithësi arrin 10 deri 30 cm, temperatura mesatare më të ulëta se minus -10 °C. Vera është e ngrohtë me temperaturë mesatare prej 23 °C dhe maksimumi nganjëherë arrin në 40 °C.

### **3.6. Gjendja hidrologjike**

Komuna e Graçanicës është e pasur me resurse ujore dhe përmes komunës kalojnë katër lumenj dhe një përrua: Graçanka, Sitnica, Prishtevka, Janjevka dhe përroi i Zhegovës. Lumi Graçanka është lum në Kosovë i cila rrjedh afër manastirit të Graçanicës, Lapnasellës, Preocës, Dobrevës

së Poshtme dhe derdhet në Sitnicë në dalje të Dobrevës së Poshtme. Buron krejt afër pendës së liqenit të Graçanicës dhe rrjedh afër deponisë minerare të minierës së Kishnicës.

Gjatësia e këtij lumi është 18,50 km. Gjendja e cilësisë së ujit në komunën e Graçanicës është në gjendje të rëndë dhe kërkon intervenime të urgjente si dhe investime të konsiderueshme në infrastrukturë. Trashëgimia e industrisë së ndotur e cila nuk ka qenë e bazuar në zhvillim të qëndrueshëm por vetëm ka keqpërdorur pamëshirshëm resurset dhe drejtpërdrejt ka ndotur brutalisht dhe ka bërë degradimin e rrjedhave ujore në territorin e komunës së Graçanicës. Gjithashtu, shumica e amvisërive ujërat e zeza i derdhin në lum, derisa një numër i caktuar i tyre edhe në ujëra nëntokësore.

### **3.7. Flora dhe fauna**

Ajo që dallon florën dhe faunën e kësaj zone janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut. Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore. Në bazë të dhënave ekzistuese, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokacion kemi të bëjmë me hapësirë natyrore, të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. Pyjet në këtë regjion mbulojnë sipërfaqen prej 1300 ha, që përbën rreth 9.9% sipërfaqes së përgjithshme të territorit të komunës së Graçanicës, por që janë në distance të konsiderueshme nga lokacioni i kompanisë Hib Petrol, stacioni i karburanteve, objekt i trajtimit nga kjo VNM. Lloji më i shpeshtë i drurit pyjor është pisha e bardhë dhe e zezë si dhe ahu. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Graçanicës e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në territorin jashtë vendbanimeve përveç kafshëve dhe shpezeve shtëpiake që i posedojnë fshatarët, në rrethin të kësaj zone, jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi, etj.

Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja, etj. Njëri ndër resurset e rëndësishme në këtë regjion është toka bujqësore e cila paraqet një peizazh të mrekullueshëm të komunës së Graçanicës. Bujqësia është e renditur si e cilësisë së lartë. Bazuar në informatat ekzistuese rreth 70 % e tokës është toka e punueshme kryesisht me të korra (gruri dhe misri). Ka edhe pemishte dhe kopshte të vogla me perime kryesisht vetëm për përdorim personal. Graçanica është kryesisht komunë rurale dhe

ekonomia e saj është shumë e varur nga prodhimi bujqësor. Pjesa më e madhe e territorit të saj është e përbërë nga tokat e kategorisë së I dhe II. Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mundë të rrezikohen me funksionimin i stacionit të karburanteve “Hib Petrol” sh.p.k. Preoc.

### **3.8. Peizazhi**

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin kompleksit i stacionit të karburanteve - mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive.

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Stacioni i karburanteve nuk ka ndonjë ndikim të ri negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse siç e cekëm më lart është i ndërtuar në zonën ku janë të ndërtuara objektet tjera afariste, prandaj ky kompleks nuk ndikon në shikuesin, sepse syri i njeriut është mësuar me këtë gjendje të mjedisit.

### **3.9. Ajri**

Gjendja në mjedisin e komunës së Graçanicës përcaktohet nga kushtet natyrore, struktura rurale, aktivitetet ekonomike, transporti dhe proceset e vazhdueshme socio-ekonomike. Mesataren vjetore të përqendrimit të gazrave ndotës në ajër e duke ju referuar të dhënave nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Stacioni për hulumtimin e cilësisë së ajrit gjendet në Prishtinë i cili mbulon sipërfaqen me diametër prej 10 km<sup>2</sup> (të dhënat: PM 10 -57,83 ng/m<sup>3</sup>; 3- 49,41 ng/m<sup>3</sup>; SO<sub>2</sub> 19,6 ng/m<sup>3</sup>; CO 3784,55 ng/m<sup>3</sup>; Hulumtimet mbi ndotjen e ajrit dhe tokës në territorin e komunës nuk ka, ndotësi më i madh i ajrit vjen nga zhurma që shkaktohet nga trafiku.



### 3.10. Uji

Numri më i madh i vendbanimeve ne këtë zonë me ujë të pijshëm furnizohen nga liqeni i Badovcit. Ndotja e ujit kryesisht shkaktohet edhe nga lëshimi i ujërave të zeza nga komuniteti të pa trajtuara, hedhja e mbeturinave ne shtratin e lumit si dhe ndotësi më i madh individual i lumit Graçankë është flotacioni i mbetjeve minerare që gjendet shumë afër shtratit të lumit dhe me shpëlarjen erozive një pjesë e madhe e llumit derdhet në lum. E qe këto ujera gjenden ne distance te konsideruar, disa kilometra nga lokacioni i stacionit te karburanteve.

## 4. PËRSHKRIMI I KOMPLEKSIT TË STACIONIT

### 4.1. Përshkrimi i projektit

Objekti i stacionit të karburanteve Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë është me etazhitet P+0 dhe ka strehën për shërbimin me karburant qe është me etazhitet P dhe strehe e terases gjithashtu me etazhitet P. Pamjet në figurën 7, ne vijim.



Figura 7. Pamjet e stacionit të karburanteve Hib Petrol në Preoc, Graçanicë

Pompa funksionon si pompe njëdrejtimëshe ka një hyrje dhe një dalje qendrore, po ashtu pjesa e administratës dhe furnizimit ka hyrje dhe dalje te veçante. I tere oborri është trajtuar me infrastrukture, kanalizim atmosferik, kanalizim fekal, rrjetin e ujësjellësit, sistemin e ujitjes si dhe sistemin e ndriçimit te oborrit.

#### Funksioni i objektit

Ky si objekt ka një funksion të përzier ku kemi hapësira administrative ne shërbim te konsumatorëve, hapësirat e shitjes, hapësirat gastronomike dhe hapësirat teknike dhe përcjellëse.

Përdhese: Përdhese është konceptuar me hyrje qendrore për ne hapësirën e marketit dhe hyrje ne skajet për administratën e përdheses dhe hyrjen tjetra për restorant. Ne përdhese janë vendosur katër grupacionet kryesore funksionale. Janë vendosur dy zyrat për punëtorë ne shërbim te klientëve qe marrin karburant, pastaj marketi dhe hapësira e restorantit dhe terrasa përcjellëse. Nga ana tjetër janë vendosur funksionet përcjellëse duke filluar nga hyrja ekonomike dhe sanitarjet për punëtor, kuzhina, depot dhe frigodhomat për deponimin e ushqimeve, si dhe kuzhina kryesore e restoranti. Ne përdhese kemi nyejet sanitare - wc për meshkuj dhe për femra.

Konstruksioni i objektit është sistem skeletor dhe është i menduar të jetë i punuar prej betonit të armuar. Moduli i konstruksionit është i zgjedhur në bazë të hapësirave funksionale dhe zgjidhjes arkitektonike. Themelet janë përvetësuar themele te veçanta me kontratave. Edhe pllaka mbi përdhese është prej betonit të armuar e projektuar si pllake me traje perimetrike dhe me kapitele ne shtyllat e mesit. Shtyllat janë të dimensionuar dhe së bashku me muret konstruktive përbëjnë skeletin e objektit.

Streha mbi hapësirën ku janë vendosur pompat për shërbimin e derivateve është e projektuar si mbulesa me konstruksion metalik e mbështetur ne pika mbështetje kontruktive me nga shtylla qift për secilën pike mbështetje. Themelet e strehës janë themele te veçuara dhe pllaka mbi themele është pllake beton arme e finalizuar me ferobeton.

#### Përdorimi i materialeve në enterier dhe në eksterier

Muret e jashtme - janë me trashësi 25 cm me blloka të trajtuara nga ana e brendshme me llaq dhe gletim kurse nga ana e jashtme me veshje me fasadë te ventiluar me teroizolim lesh guri. Ana ballore është e punuar me fasade kontinuale nga alumini me xham tero E-low

me eficiency termike shume te mire. Këto mure në pjesën hyrëse te objektit në përdhese shërbejnë që të kemi një lidhje më të mirë vizuale nga jashtë në brendinë e objektit.

Muret e brendshme - të gjitha muret e mbrendshme janë nga blloqet moderne, të suvanuara me llaq dhe do gletuara deri në finale. Muret të cilat i ndajnë nyjat sanitare, depotë dhe kuzhinën janë mure nga blloqet e siporeksit te suvatuara me llaq me baze qimentoje dhe të veshura me pllaka të qeramikës.

Dyshemetë - në te gjitha hapësirat, sanitaret, gardërobat, kuzhina është menduar të vendosen pllakat e qeramikës teknike kurse ne pjesët tjera ku janë marketi, restorani dhe administrate janë me pllaka porcelani.

Ndriçimi - në hapësirat funksionale kryesisht është ndriçim natyral por ka edhe ndriçim artificial të dimensionuar në mënyrë adekuate për funksion të objektit.

Zgjedhja arkitektonike e objektit - forma e objektit është kryesisht si rezultat i funksionit të brendshëm dhe idesë së arkitekturës të cilën e kemi menduar. Është një arkitekturë e kombinuar nga arkitektura organike për nga forma, dhe në momente për nga përdorimi i materialeve, si dhe në anën tjetër shihen disa lëvizje të arkitekturës moderne.

Pajimet dhe objektet që përbëjnë kompleksin e stacionit të karburanteve:

- Objekti i cili përmban hapësirën për administratë, hapësirën për shitjen, hapësirën për restorant me sipërfaqe rreth 700 m<sup>2</sup>
- Bodrumi me sipërfaqe rreth 700 m<sup>2</sup>, i destinuar si depo për deponim te materialeve përkatës , gardërobe dhe funksione tjera mbështetëse te këqij aktiviteti.
- Terasa e restorantit me sipërfaqe rreth 280 m<sup>2</sup>
- Platoja e pompës rreth 600 m<sup>2</sup>
- Rezervarët e naftës (3)
- Rezervarët e benzinës (3)
- Rezervuari i gazit (1)
- Pompa për naftë (12) me aparatet për toçitje gjithsej (24)
- Pompa për benzinë (12) me aparatet për toçitje gjithsej (24)
- Pompa për gazë (1) me aparatet për toçitje gjithsej (2)
- Seperator i për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura.
- Hapësirat e parkingjeve
- Oazat gjelbëruese.

- Rrethoja e lokacionit.
- Shtyllat e reklamës.

Për funksionimin normal të stacionit për furnizim dhe distribuim me karburant (naftë dhe benzinë), si dhe lëndë djegëse të gazta (propan-butan), janë ndërtuar edhe objekteve përcjellëse të stacionit të karburanteve si vendosa e rezervarëve për derivate dhe aparateve për toçitje edhe seperatori për ujërat, është e rregulluar – e betonuar platoja funksionale, grumbulluesit dhe sistemi për bartjen e ujërave.

## **4.2. Objektet tjera dhe infrastruktura përcjellëse**

Përveç objekti të stacionit të karburanteve, të përshkruara deri me tani, në pjesën perëndimore të ngastrës, ngjitur me objektin e përshkruar me lartë gjendet edhe objekti i administratës qendrore të Hib Petrol me etazhitet – tre nivele, që do të përshkruhet si në vijim.

Siç thamë ngastra ka dalje në rrugën magjistrale “Prishtinë-Ferizaj”. Vijat rregullative të ngastrës janë në kufijtë e parcelës. Vija ndërtimore nga skaji i rrugës kryesore magjistrale “Prishtinë-Ferizaj” në anën lindore është 74.00 m’ kurse në anën perëndimore deri tek hoteli 55.00m’, kurse ndaj fqiu në anën veriore është 40.00 m’ e nga fqiu në anën jugore 65.00 m’. Objekti është me etazhitet P+2.

Funksioni i objektit, Ky objekt është i destinuar si objekt administrativ pra funksioni kryesor është administrative por përveç këtij funksioni që përfshinë zyrat administrative është edhe hapësira për rekreacion, kuzhina, recepsioni dhe atriumi.

Përdhese: është konceptuar me hyrje qendrore ku ndodhet recepsioni dhe holli i pritjes, ndërsa pjesa tjetër është kryesisht zyre administrative me sipërfaqe të ndryshme ku përfshihen 7 zyre. Në këtë kate përfshihet edhe kuzhina për stafin.

Kati i parë: Shërben si kate me destinim totalisht administrativ ku përfshihen 9 zyre administrative me sipërfaqe të ndryshme

Kati i dytë: Përveç pjesës administrative në këtë katë përfshihet edhe pjesa për rekreacion.

Konstruksioni i objektit është sistem skeletor dhe është i menduar të jetë i punuar prej betonit të armuar. Moduli i konstruksionit është i zgjedhur në bazë të hapësirave funksionale dhe zgjidhjes arkitektonike. Themelet janë përvetësuar themelet e vazhduara. Edhe pllaka mbi përdhese është prej betonit të armuar e projektuar si pllake me traje.

Shtyllat janë të dimensionuar dhe së bashku me muret konstruktive dhe bërthamën përbëjnë skeletin e objektit.

Kulmi mbi katin e dyte është projektuar si kulm i rrafshët i pashfrytëzuar i parapare me shtresat përkatëse izoluese.

Muret e jashtme janë me trashësi 25 cm me blloka të siporeksit të trajtuara nga ana e brendshme me llaq dhe gletim kurse nga ana e jashtme me veshje me fasadë te ventiluar me termoizolim lesh guri  $t= 8$  cm. Ana ballore është e punuar me fasade kontinuale nga alumini me xham E-low me efqiçnce termike shume te mire me koeficient termik  $1.1 \text{ W/m}^2 \text{ K}$ . Këto mure në pjesën hyrëse te objektit në përdhese shërbejnë që të kemi një lidhje më të mirë vizuale nga jashtë në brendinë e objektit.

Muret e brendshme, Të gjitha muret e brendshme janë nga blloqet e siporeksit të cilat do të suvatohen me llaq dhe do gletohen deri në finale. Muret të cilat i ndajnë nyjat sanitare, depotë dhe kuzhinën janë të veshura me pllaka të qeramikës.

Dyshemetë - Në te gjitha hapësirat, sanitaret, kuzhina është menduar të vendosen pllakat e keramikës teknike kurse ne pjesët tjera ku zyrat administrate janë me pllaka porcelani. Shkallet do te shtrohen me granit artificial.

Ndriçimi në hapësirat funksionale kryesisht është ndriçim natyral por ka edhe ndriçim artificial të dimensionuar në mënyrë adekuate për funksion të objektit. Ne pjesën e korridoreve ndriçimi natyror vjen nga atriumi.

Zgjedhja arkitektonike e objektit ose forma e objektit është kryesisht si rezultat i funksionit të brendshëm dhe idesë së arkitekturës të cilën e kemi menduar.

Është një arkitekturë e kombinuar nga arkitektura organike për nga forma, dhe në momente për nga përdorimi i materialeve, si dhe në anën tjetër shihen disa lëvizje të arkitekturës moderne.

### **4.3. Platoja e kompleksit**

Platoja e stacionit të karburanteve është rregulluar ashtu që pjerrtësia të jetë e përshtatshme për përcjelljen e ujërave sipërfaqësore, të tërë pjesës për rreth objektit administrativ dhe për rreth objektit për shitjen e karburanteve është e betonuar.

Organizimi për funksionimin e këtij stacioni të karburanteve është i destinuar për funksionimin e qarkullimit ne rrugën ndërlidhëse, hyrja dhe dalja e automjeteve në

kompleksin e stacionit të karburanteve bëhet pa pengesa sepse hapësira për hyrje në stacion të karburanteve dhe dalje është e mjaftueshme dhe dukshmëria është e mirë.

#### **4.4.Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta - naftë dhe benzinë**

Në stacioni i karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë janë vendosur rezervuar për deponitimin e naftës dhe benzinës me vëllim (figura 8, ne vijim):

V = 29891 litra, 31792 litra, 48657 litra, 29643 litra, 30072 litra dhe 49165 litra.



Figura 8, rezervari e naftës dhe benzinës

Rezervarët janë cilindrik të ndërtuar prej çelikut me mure të dyfishtë sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të lëngtë (Naftë dhe benzine) dhe janë të vendosur nën tokë në pozitë horizontale, në hapësirën e betonuar dhe të rrethuar me mure betoni, të mbështetur në tri mbajtëset (shalat) nga betoni dhe të shtrënguar me nga dy shirita metalik anti korroziv për secilën mbajtëse, me qëllim të përforcimit për të mos lëviz nga presionet e ndryshme nëntokësore.

Mbrojtja nga korrozioni bëhet për mes sistemit të katodës dhe me ngjyrë konform standardeve.

Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve bëhet nëpër mes të sistemit të gypave special të cilët janë të vendosur në kanal prej betoni për mbrojtjen e tyre nga dëmtimet eventuale.

#### **4.5. Rezervari për karburant të gaztë**

Ne stacioni i karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë është i vendosur edhe rezervari për deponim dhe distribuim të karburantit të gaztë (propan-butan) me kapacitet prej 15000 litra (figura 9, në vijim):



Figura 9, rezervari e gazit.

Rezervari cilindrik është i vendosur në tokë në pozitë horizontale, i përforcuar dhe vendosur në mënyrë profesionale, në baze të projektit kryesor të ndërtimit të stacionit të karburanteve. Rezervari do të ndërtohet prej çelikut sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e lëndëve djegëse të gazta për të cilin ekzistojnë dëshmitë nga prodhuesi. Siguria aksidentale zvogëlohet pasi rezervari është i vendosur nëntokë.

#### **4.6. Karakteristikat e procesit në stacionin e karburanteve**

Procesi teknologjik në stacionin e karburanteve do të përfshin këto operacione të veprimit që janë të ndërlidhura në mes veti.

- sistemi për zbrazje
- sistemi për deponimin e karburanteve

- sistemi për dhënien (toçitjen ) e karburanteve
- Sistemi për zbrazje të karburanteve të lëngët bëhet nga autocisternat me ramje të lirë (apo me anë të pompës) përmes sistemit të gypave prej gome, të cilët përmes një kyçje speciale lidhen me gypin në rezervuar.

Matja e sasisë së deponuar në rezervuar do të matet drejtpërdrejt nga instrumentet matëse të vendosur ne autocisternë ose përmes levës së bazhdaruar dhe tabelave të veçanta për çdo rezervuar. Sistemi i gypave dhe instrumenteve matëse kontrollohen para zbrazjes, në mënyrë që të eliminohen dukuritë e situatave aksidentale.

Sistemi për deponim të karburanteve përbëhet nga dy rezervar për depozitimin e naftës, dy rezervuara te benzinës dhe një rezervari për karburant të gaztë (propan-butan).

Kapaciteti i këtyre rezervuarve është përshkruar ne piken 4.4. dhe 4.5.

Sistemi për dhënien apo toçitjen e karburanteve të lëngët te naftës dhe benzinës, përbëhet nga 12 +12 pompa me nga 24 + 24 gypa për toçitje dhe një pompe me 2 gypa për toçitje te gazit. Sistemi për dhënie të karburanteve funksionojnë ne mënyrë automatik dhe janë të mbrojtur nga rreziqet eventual.

## **4.7. Komponentët hyrëse në procesin teknologjik**

Komponentët hyrëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë:

- Karburantet djegëse te lëngëta (naftë dhe benzinë).
- Karburant të gaztë (propan-butan)
- Energjia elektrike dhe uji.

Karburantet djegëse te lëngëta benzina dhe nafta shërbejnë për furnizimin e automjeteve, për nevoja ne amvisni ne industri etj. Sasia e përgjithshme e karburanteve ne stacionin e karburanteve (nafte dhe benzine) është dhënë ne piken 4.4.

Karburantet e gaztë (propan-butan) shërbejnë si lëndë djegëse për automjete, në amvisëri apo në industritë e ndryshme si dhe për automjete që shfrytëzojnë gazin si lëndë djegëse. Sasia e karburanteve të gazta ne stacionin e karburanteve është dhen ne pike 4.5.

Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike do të bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike. Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për larjen e platosë së stacionit të karburanteve dhe për



furnizim të pajisjeve kundër zjarrit. Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten rreth 25 litra ujë/ditë.

Furnizimi me ujë në kompleksin e stacionit të karburanteve i cili shfrytëzohet për qëllime sanitare bëhet nga sistemi i ujësjellësit.

#### **4.8. Komponentët dalëse në procesin teknologjik**

Komponentët dalëse gjatë aktiviteteve që zhvillohen në stacionin e karburanteve janë :

- Karburantet djegëse të lëngëta (naftë dhe benzinë) dhe gazta (propan- butan).
- Ujërat e ndotura.
- Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga automjetet.
- Zhurma.
- Mbeturinat e ngurta.

#### **4.9. Alternativat e projektit**

Janë analizuar alternativat tjera për lokacione të mundshme, por marre parasysh lokacionin aktual të Stacionit të karburantit “Hib Petrol”, në Preoc, Graçanicë, i cili gjendet në rrugën magjistrale Prishtinë – Ferizaj, ky lokacion është vlerësuar me përparësi. Përparësitë e këtij lokacioni janë, qasja në rrugën magjistrale, e lehtë dhe e frekuentuar nga shumë makina në lëvizje, zona është tipike biznesore, larg vendbanimeve dhe në distance të mira nga objektet tjera.

Alternativat në aspektin e sigurisë, po ashtu në këtë lokacion vlerësohen me përparësi të dukshme. Alternativat e këtij lokacioni në aspektin mjedisor, janë të qëndrueshme, sepse kemi të bëjmë me zone tipike industriale – biznesore, në distance të mjaftueshme nga vendbanimet.

Po ashtu është shqyrtuar edhe alternativat e tipi të ndërtimit dhe është zgjedhur ky projekt, i cili plotëson standardet e sigurisë teknike dhe ndikimeve minimale në mjedis.

Gjithashtu, alternative e qëndrueshme e këtij projekti është edhe aspekti ekonomik, i zhvillimit të biznesit, në harmoni me mjedisin dhe sigurinë – pra zhvillimin e qëndrueshëm.

## **5. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS**

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e proceseve (veprimeve) që kryhen në stacionin e karburanteve tregojnë se deri te kvantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kvantifikimi i tyre.

Gjatë punës kontinuele të stacionit të karburanteve vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga puna e automjeteve, avullimi i karburantit benzinë, avullimi i karburantit të gaztë (propan-butanit), derdhjet dhe avullimi i karburanteve të lëngët, krijohet zhurmë nga motorët e automjeteve dhe funksionimi i automatëve për dhënie të karburanteve.

Në mënyrë indirekte mund të vjen edhe te deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër stacionit të karburanteve.

Entitetet e cenueshme që potencialisht rrezikohen janë të punësuarit në stacion dhe shfrytëzuesit e shërbimeve - konsumatorët.

### **5.1. Ndotja e tokës**

Toka si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vjen deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja.

Në fazën e shfrytëzimit të stacionit të karburanteve ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platos së stacionit të karburanteve dhe nga funderrimet e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve.

Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin.

Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër stacionit të karburanteve varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së stacionit të

karburanteve, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e stacionit të karburanteve.

## **5.2. Ndotja e ujit**

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vjen deri te shpërthimet e rezervarëve me karburant të vendosur në tokë. Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së derivateve.

Pastaj gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vjen deri te sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike, i fshirjes së gomave të automjetit, i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara , i fundërrimeve nga atmosfera.

Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese të stacionit të karburanteve pritet të jenë gjatë zezonave të dimrit kur kemi hedhjen e kripës nëpër magjistrale.

Koncentrimet e ndotësve të sedimentuar në platon e stacionit të karburanteve drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga dendësia e qarkullimit të automjeteve.

Koncentrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të reshurat atmosferike ku koncentrimet më të mëdha janë në 5- 10 minutat e para të shpëlarjes së sipërfaqes së pllatoes nga personeli apo nga të reshurat atmosferike.

## **5.3 Ndotja e ajrit**

Gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve nga qarkullimet e automjeteve vjen deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve .

Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrimet të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë: CO, NO<sub>x</sub>, HxCy, SO<sub>2</sub> dhe Pb.

Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.

## **5.4. Zhurma**

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj.

Lokacioni i stacionit të karburanteve me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve, autocisternave dhe nga funksionimi i pompave dhe kompresorëve për zbrazjen dhe shpërndarjen e karburanteve dhe në mungesë të energjisë elektrike kyçja e shpeshtë e agregatit për energji elektrike.

Sipas gjendjes faktike të kompleksit stacionit të karburanteve në lokacionin e analizuar mundë të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar prej 60 dB .

## **5.5. Ndikimet në florë dhe faunë**

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vjen deri te ndikimet në florë dhe faunë.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe në platonë stacionit të karburanteve kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentrim të vogël të polutantëve.

E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, se fauna edhe ma herët nuk ka ekzistuar në këtë lokacion sepse stacioni i karburanteve është ndërtuar në lokacionin që kanë ekzistuar vendbanime.

## **5.6. Ndikimi mjedisor nga mbeturinat dhe menaxhimi i tyre**

*Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi i tyre* - mbeturinat të cilat gjenden gjatë aktivitetit të Stacionit të karburanteve, të ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në

kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në djeponit regjionale për trajtim të mbeturinave.

Mbeturina	Emiri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
	Letër	Jo të rrezikshme	Kontejner
170203	Plastike	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
150101 200101 200108	Mbeturine e ngurtë komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

*Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave* - gjatë aktivitetit të Stacioni i karburanteve, bëhet magazinimi i përkohshëm i mbeturinave të ngurta komunale të cilat grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim.

Mbetjet urbane deponohen në kontejner dhe menaxhohen nga kompania lokale e qytetit, si mbetjet urbane tjera.

*Menaxhimi i mbeturinave* - klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave Kompania Stacioni i karburanteve e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060.

Mbeturinat e ngurta komunale, grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor. Kompania Stacioni i karburanteve, riparimin dhe ndërrimin e vajrave të automjeteve transportuese, autocisternave e bënë tek autoserviset e kontraktuar andaj nuk gjeneron vajra mbeturinë.

## **5.7. Përshkrimi i pasojave të mundshme mjedisore të projektit**

Ndikimet mjedisore me pasoja të mundshme nga ushtrimi i aktivitetit të stacionit të karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë, teorikisht janë të mundshme, andaj janë analizuar ndikimet specifike dhe në baze të shkallës së mundshme të ndikimit, do të propozohen masat përkatëse për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis.

### **5.7.1. Rreziqet e mundshme ne mjedis - shëndetin e njeriut nga fatkeqësitë ose katastrofat**

Në rast fatkeqësisë ose katastrofave, në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë manipulimit me derivate të naftës në stacionin e karburanteve është derdhja e derivateve të naftës deri në at sasi që rrezikon mjedisin, prandaj është e nevojshme që të bëhet sanimi i ndotjes sipas metodave adekuate adekuate ne parandalimin e këtyre rasteve dhe metodave përkatëse për sanimin dhe rehabilitimin e pasojave, nëse ndodhe diçka e tille.

Rrezikimi i mjedisit në stacionin e karburanteve në rastet fatkeqësive ose katastrofave mjedisore – me e mundur te vjete eshte nga prania e gazit të lëngët naftor (GLN).

Masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave (EPA) analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza:

- identifikimi i rrezikut,
- analiza e pasojave dhe
- vlerësimi i rrezikut.

Kjo çështje ne hollësi do te trajtohet ne kapitullin 6 – vlerësimi i ndikimit të mjedisit nga aksidentet e mundshme.

### **5.7.2. Ndikimet e mundshme në trashëgiminë kulturore**

Si pas hulumtimit të materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar ne teren, ne lokacionin e ngushte, ku gjendet stacioni i karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë, nuk kemi monumente te trashëgimisë kulturore, historike e natyrore te cilat eventualisht do te ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë se stacionit te karburanteve.

Ne lokacionin me te largët përreth stacionit te karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë, aktivitetet e këtij stacioni te karburanteve nuk kanë ndikime mjedisore dhe rreziqe ekcesiale në hapësirë.

## **6. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË MJEDISIT NGA AKSIDENTET E MUNDSHME**

Me që kemi të bëmë me stacionin e karburanteve ku do të kemi deponimin dhe distribuimin e karburanteve të lëngët dhe të gaztë nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale. Në rastet e jo zakonshme, gjatë derdhjes jo të kontrolluara të karburanteve të lëngët mund të vjen deri te aksidentet kimike, intensiteti aksidental i të cilëve mund të jetë i shkallëve të ndryshme.

Nga manipulimet e ndryshme vepruese me derivatet e naftës në stacionin e karburanteve mund të vjen deri te rrjedhja apo derdhja e sasive të karburanteve ku nga avullimi i tyre sjell deri te ndotja e ajrit në hapësirën e stacionit dhe hapësirën për rreth tij. Në aspektin teorik aksidentet e një shkalle më të lartë në stacionin e karburanteve mundë ndodhin në rezervuarët me karburante të vendosur në tokë e sidomos gjatë derdhjes (rrjedhjet) si dhe nga auto cisternat.

Të gjitha situatat aksidentale gjatë deponimit dhe distribuimit me derivate të lëngëta mund të i kategorizojmë në katër grupe:

- Eksplodimi i avullit të karburanteve që janë në gjendje vlimi
- Eksplodimi i gazrave të reve të pakufizuara
- Eksplodimet e kufizuara
- Zjarri

Aksidentin e parë duhet përjashtuar nga analiza sepse për të ardhur deri te ky aksident karburanti në rezervuar duhet të jetë mbi temperaturën e vlimit.

Aksidenti i dytë mund të shkaktohet gjatë manipulimit me benzinë në stacionin e karburanteve ku mund të vjen deri te përzierja e avullit të karburanteve me ajrin dhe të krijojnë një përzierje potenciale e cila gjatë koncentrimëve të caktuara dhe energjisë së mjaftuar për aktivizim mund të shkaktojë detonacion eksplozues me pasoja të mëdha.

Mundësia e një aksidenti të tillë është shumë e vogël kur kemi parasysh lokacionin e objektit, sasinë e derivateve, dendësinë e automjeteve të cilat furnizohen me derivate, shpejtësinë e avullimit të karburanteve etj. Në shkallën e detonacionit të një reje nga përzierja e avullit të benzinës dhe ajrit, mjaft ndikon edhe numri i oktanëve të benzinës - benzina prej 86 apo 98 oktan në vete përmban tetraetil plumbi që është si mjet

antidetonus, pastaj me qëllim të ngritjes së numrit të oktanëve benzinës i shtohen edhe hidrokarbure aromatike benzol ( $C_6H_5OH$ ), toluol ( $C_6H_5CH_3$ ) dhe nëse kjo shtesë është mbi 7% atëherë praktikisht është e pamundur të vjen deri te një detonacion i reve të përzierjes së avullit të benzinës me ajër.

Mundësia e një eksplozimi të kufizuar në rezervuarët me karburante në tokë është praktikisht e pamundur kur kemi parasysh faktin se rrjedhja e benzinës nga rezervuarët në tokë nuk kontaktojnë me ajrin .

Sa i përket zjarrit mundë të konstatojmë se realisht është e mundur por nuk do të bëjmë ndonjë analizë detale mbi vlerësimin e rrezikut nga zjarri kur kemi parasysh faktin se do të ekziston *“projekti kundër zjarrit dhe mbrojtja nga zjarri”* si dhe të gjitha masat preventive që duhet të ndermirren gjatë një aksidenti nga zjarri.

Në rastet e aksidentit nga zjarri në lokacionin dhe rrethinën e stacionit të karburanteve mundë të rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut si dhe mjedisi rrethues, kur kemi parasysh toksitetin e produkteve të djegies (monoksidi i karbonit dhe formaldehidet), masën e gaztë të produkteve të djegies, shkallën e nxehtësisë, produktet jo plotësisht të djegura të derivateve të naftës etj.

Në kuptim më të gjerë, rast aksidental në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë manipulimit me derivate të naftës në stacionin e karburanteve është derdhja e derivateve të naftës deri në at sasi që rrezikon mjedisin, prandaj është e nevojshme që të bëhet sanimi i ndotjes sipas metodave adekuate. Nëse rregullorja e punës së një stacioni të karburanteve përmban në detale të gjitha aktivitetet dhe veprimet për sanimin e aksidentit nga derdhjet e derivateve, mund të konstatojmë se derdhjet e derivateve të lëngëta nuk mundë të rrezikojnë mjedisin.

Rrezikimi i mjedisit në stacion në rastet aksidentale buron edhe nga prania e gazit të lëngët naftor (GLN) të deponuar në stacionin e karburanteve.

Në pajtim me nenet e rregullores mbi metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë nga aksidenti kimik dhe nga ndotja e mjedisit, masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave (EPA) analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza:

- Identifikimi i rrezikut
- Analiza e pasojave
- Vlerësimi i rrezikut



Identifikimi i rrezikut nënkupton procesin e mbledhjes së të dhënave mbi materiet e rrezikshmërisë në proces si dhe verifikimin e të gjitha pikave kritike të procesit dhe stabilimenteve. Sipas EPA standardeve, gazi i lëngët naftor (GLN) paraqet një përzierje të hidrokarbureve të naftës (propan, popen, butan dhe izomeret e tyre ), presioni i avullit i të cilëve kalon  $1.25 \text{ kPa/cm}^2$  në  $40 \text{ }^\circ\text{C}$ .

Disa nga veçorit e rëndësishme të GLN janë:

Në përdorimin komercial më së shpeshti janë butani dhe propani që butani dhe propani në temperaturë normale janë në gjendje të gaztë por nën presion mundë të kalojnë në gjendje të lëngët. GLN është gaz pa ngjyrë, dendësia e tij në gjendje të lëngët është  $\frac{1}{2}$  e dendësisë së ujit, si lëngë është  $\frac{1}{250}$  pjesë e vëllimit të gaztë.

GLN në temperaturë normale ka dendësi më të madhe se ajri dhe nuk dispergohet lehtë.

E ka vetin që pas derdhjes lëshohet ne pikat më të ulëta të sipërfaqes, dhe mund të akumulohet ne vrima dhe vende tjera me presion të ultë. GLN me ajrin formon përzierje eksplozive në raporte të caktuara volumore

Në koncentrimet të larta vepron si anestetik sepse me zvogëlimin e presionit parcial të oksigjenit shkakton vështirësi në frymarrje. Gjatë derdhjes (zbrazjes) nga rezervari, avullohet shpejt dhe me uljen e temperaturës mundë të shkaktojë mërdhisje. GLN-së zakonisht i shtohen aromat karakteristike për identifikim më të lehtë.

Në tabelën në vijim po i paraqesim karakteristikat themelore të vetive fiziko - kimike të gazit të lëngët naftor.

Tabela 1. karakteristikat themelore të vetive fiziko - kimike të gazit të lëngët naftor

Karakteristikat	Butani komercial	Propani komercial
Dendësia relative e GLN-së së lëngësuar ne $15.6^\circ\text{C}$	0.57-0.68	0.50-0.51
Litra/ton të lëngut ne $15.6^\circ\text{C}$	1723-1760	1957-2019
Dendësia relative (ndaj ajrit) ne $15.6^\circ\text{C}$ dhe 1015.8 mbar	1.90-2.10	1.40-1.55
Raporti i vëllimit gaz:lëng ne $15.6^\circ\text{C}$ dhe 1015.8 mbar	233	274

Temperatura e vlimit °c	-2	-45
Tensioni i avullit ne 20°c bar	2.5	9
Tensioni i avullit ne 50°c bar	7	19.6
Kufiri i ultë i eksplozivitetit % v/v	1.8	2.2
Kufiri i lart i eksplozivitetit % v/v	9.0	10.0

Përveç identifikimit të materieve të dëmshme në proces ,në fazën e parë të analizës së rrezikshmërisë duhet bërë identifikimin e burimeve të rrezikut.

### **6.1.1. Analiza e trungut të ngjarjeve**

Ngjarjet të cilat pasojnë në rastet aksidentale mund të kenë karakteristika të ndryshme. Në vijim do të paraqesim disa nga mundësit e zhvillimit të ngjarjeve gjatë aksidentit.

- Reja e formuar lëviz te poshtë:
- inicimi ndodh menjëherë pas formimit të sferës së nxehtë
- inicimi ndodh më vonë ,krahas shkaktimit të zjarrit ose eksplozimit të resë
- nuk vjen deri te inicimi
- Reja e formuar lëviz përpjetë:
- inicimi ndodh menjëherë krahas formimit të resë së zjarrtë
- largohet nga rezervari dhe vjen deri te inicimi ose eksplozimi i resë
- nuk vjen deri te inicimi.

### **6.1.2. Mundësitë e ndikimeve nga rezervarët**

Në rast se aksidenti e përfshin tërë rezervarin, ekzistojnë dy mundësi :

- a) aksidenti në rezervarin e nxehtë
- b) aksidenti në rezervarin e ftohtë

Inicimet e mundshme në tërë rezervarin janë: sfera e zjarrit , zjarri , eksplozimi i resë së gaztë dhe disperzioni i resë pa inicim

Aksidenti në rezervarin e nxehtë nënkupton veprimin e temperaturave të larta jashtë rezervarit, në këtë rast supozohet se tërë sasia e GLN-së është liruar nga rezervari dhe është djegur si sferë e zjarrtë.


Aksidenti në rezervarin e ftohtë nënkupton avullimin e menjëhershëm dhe formimin e resë së gaztë krahas përzierjes turbulente me ajrin.

### 6.1.3. Aksidenti në pjesë të rezervarit (vrina në rezervar)

Ngjarjet e mundshme në këtë rast janë:

- formimi i resë e cila lëvizë
- inicimi me krijimin e resë së avullit që eksplodon
- shkaktimi i zjarrit, pa inicim.

Reja mund të dispergojë, varësisht nga kushtet aktuale klimatike, figura 10, ne vijim.



### 6.1.4. Aksidenti në sistemin shpërndarës

Aksidenti në këtë rast është pasojë e rrjedhjes (derdhjes) së GLN-së nga sistemi shpërndarës dhe mund të çojë deri te:

- o flaka kur vjen lëvizja deri te inicimi
- o formimi i resë dhe lëvizja e saj me:
  - inicim dhe formim të resë së avullit e cila eksplodon,
  - shkaktim të zjarrit
  - ose nuk ka inicim.

## 6.2. Analiza e pasojave

Analiza e pasojave është faza e dytë e analizës së rreziqeve dhe për qëllim parashikon vëllimin e pasojave të mundshme të aksidentit dhe nivelin e dëmit.

Pasojat kryesore të mundshme të aksidentit në kompleksin e Stacionit janë:

- BLEVE (Bilong Liquid Expanding Vapor Explosions – eksplozimet e avullit ekspandues të lëngut të vluar):
- VCE ( Vapor Cloude Explosion – eksplozimi i resë së gazit)
- Zjarri
- Dispergimi i resë pa inicim.

### 6.2.1. BLEVE

Masa e GLN – së, e cila merret të jetë 80% të vëllimit të rezervuarit. Supozohet se sfera e zjarrit e ka formën sferike dhe është afër tokës.

Për rezervarin me vëllim prej  $15 \text{ m}^3 \times 0.8 = 12 \text{ m}^3$  (80% të vëllimit të rezervuarit) diametri i sferës së zjarrit mund të jetë gjer rreth 20 m. Kohëzgjatja e sferës është më pak se 10s, në këto rrethana mund të shkaktohen lëndime të djegies se shkallës së tretë në pjesët e zbuluara të lëkurës.

### 6.2.2. VCE

Madhësia e mbi presionit të krijuar në këtë rast mund të njehsohet në distanca të caktuara nga burimi. Tabela 2. Ndikimet e mundshme janë ilustruar në vijim.

Mbi presioni në front të valës goditëse (bar)	Efekti
0.3	Rrënime të kufizuara Të padëmshme për njerëz
0.4	Rrënime mesatare të ndërtesave Lëndime mesatare të njerëzve në mjedis hapur
0.6	Rrënime të konsiderueshme të ndërtesave Lëndime të mesme të njerëzve
0.8	Rrënime të tërësishme të ndërtesave Lëndime të rënda të njerëzve

### 6.2. 3. Zjarri në rezervuar

Zjarri në rezervuar shkakton rrezatim termik, që paraqet rrezik për njeriun dhe për objektet përreth. Për të kuantifikuar efektin e veprimit të zjarrit është përvetësuar që doza e rrezatimit 1000 njësi ( $\text{kW}/\text{m}^3$ ) shkakton djegie të konsiderueshme në lëkurën e zbuluar të njeriut.

Tabela 3. është dhënë varësia e dozës së rrezatimit nga diametri i zjarrit.

<i>Diametri</i>	<i>Doza ( njësi)</i>
1.1 D	3.000
1.2 D	2.300
1.3 D	100
1.4 D	200
(Për njerëzit në objekte)	
Deri në 1.1 D	2.300
Mbi 1.1 D	0

Në rast se zjarri shkaktohet në sistemin shpërndarës, përkatësisht në gypat e këtij sistemi, karakteristikat e zjarrit që shkaktohet do të paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela 4. Karakteristikat e zjarrit të GLN – së në sistemin shpërndarës

Diametri i gypit (mm)	25	50	75	100	150
Gjatësia e flakës (m)	10 – 15,	20 – 30,	30 – 45,	40 – 60,	60 - 90
Gjerësia e flakës (m)	3.5 – 5,	7 – 10,	10 – 15,	14 – 20,	20 -30

### 6.3 Vlerësimi i rrezikut

Rreziku nga aksidenti vlerësohet në bazë të gjasave të ndodhjes së aksidentit dhe vëllimit të pasojave.

### 6.3.1. Vlerësimi i gjasave të ndodhjes së aksidentit

Gjasat e ndodhjes së aksidentit vlerësohen në bazë të dhënave mbi ngjarjet dhe aksidentet në pajisjet (stabilimentet) e njëjta ose të ngjashme në vendet tjera dhe të dhënave të përfituara nëpërmjet identifikimeve të rreziqeve.

Në tabelën në vijim janë paraqitur gjasat e ndodhjes së aksidenteve sipas të dhënave të publikuara në simpoziumin ICHEME të mbajtur në Budapest në vitin 1991.

Ngjarja	Gjasat	Distanca (m)
Derdhje të vogla	Të mëdha	10
Çarja e gypave, lidhëseve	Të vogla	10 - 100
Çarja e rezervarit dhe sfera e zjarrtë	Shumë të vogla	Mbi 100
Çarja e rezervarit VCE	Tejet të vogla	Mbi 100
Çarja e rezervuarit, formimi i resë	Tejet të vogla	Mbi 100

Sa i përket zjarrit klasik, duhet konstatuar se projekti përkatës i mbrojtjes nga zjarri duhet të kalojë revizionin, kështu që në këtë raport nuk do të analizohet.

### 6.3.2. Vlerësimi i pasojave të mundshme

Pasojat e mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin parashtrohen në bazë të dhënave të përfituara me analizën e cenueshmerisë. Me anë të analizës së cenueshmerisë evidentohen të gjitha entitetet dhe objektet e cenueshme në rrethinën e burimit potencial të aksidentit:

- të punësuarit në kompleks
- pjesëmarrësit në trafik në rrugë
- objektet afariste dhe të banimit

Në bazë të analizës së lëndueshme risë mund të vlerësohet se në situatën më të pafavorshme (15 000 litra gaz), pasojat e mundshme të aksidentit do të shpreheshin deri në distancë rreth 20 m. Siguria aksidentale zvogëlohet pasi rezervari do të vendoset në tokë prandaj pasojat e mundshme të aksidentit do të shpreheshin në distancë më të vogël.

## **7. MASAT E MBROJTËS SË MJEDISIT**

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e stacionit të karburanteve në mjedis, si dhe në bazë të vlerësimit të kompleksit i cili do të punohet sipas projektit kryesor të ndërtimit dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, stacioni i karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë, me veprimtarinë kontinuele të sajë, sipas këtij raporti nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë parashihet që në rast se vie deri te ndotja duhet të ndermirën masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor.

Me qëllim të zvogëlimit të mëtejme të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në stacionin e karburanteve në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.

### **7.1. Masat mbrojtëse të ujërave**

Edhe pse stacioni i karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë, nuk ka ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, por ndotja ndodh si që e kemi përshkruar në pasuset e mësipërme.

Në kompleksin e stacionit të karburanteve duhet të funksionoj sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipulative, dhe dërgohen në seperator për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura.

Separatori për vajra me kapacitet mesatare ( sipas projektit), për mes mureve në disnivele e bën ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon në pesetën e posaçme, ku pas mbushjes së pusëtës pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorve.

Separatori përmbush kriteret teknike që janë të parapara me rregullore dhe normative në fuqi. Funksionon grupa septike për trajtimin e ujërave të zeza e pastaj pas gropës septike ujërat e trajtuara dërgohen në bunarin filtrues.

Separatori do të funksionoj sipas standardeve në hapësirën që shihet në planin e situacionit që ia bashkëngjisim raportit të VNM-s.

Seperatorori për mes mureve ne disnivele e bën ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon ne pesetën e posaçme, ku pas mbushjes së pusetës pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e separatorve. Seperatorori duhet të përmbush kriteret teknike që janë te parapara me rregullore dhe normative ne fuqi.

Seperatorori eshte rregulluar në at mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet.

Eshte dërtuar grupa septike për trajtimin e ujërave të zeza e pastaj pas grupës septike ujërat e trajtuara të dërgohen ne bunarin filtrues.

Ujërat e trajtuara ne separator duhet te dërgohen ne bunarin filtrues.




Figura 11. Separtori për trajtim te ujerave.

Ujërat nga separatori nuk lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate të naftës mbi 1 mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.

Ujërat nga separatorët dhe grupa septike nuk lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi vlerat e përcaktuara me Udhëzim administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet ne trup uJORë dhe ne rrjetin e kanalizimit publik ( 13/2008).

Për pos masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara ne pasuset e mësipërme investitori duhet të i ndërmerr edhe këto masa:



- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative tëra hapësirat operacionale në të cilat bëhet manipulimi me karburante duhet të mbulohen me beton ose asfalt.
- Furnizimi me ujë pije si dhe për nevoja tjera sanitare bëhet nga sistemi i ujësjellësit, kurse furnizimi i ujit që shfrytëzohet për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajimet për zjarre fikje do të bëhet nga pusi i thellë që duhet hapur nga pronari .
- Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat të përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm duhet të grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën në seperator.
- Ujërat fekale nga nyjat sanitare përmes gypave dërgohen në gropën septike.
- Rregullisht të bëhet kontrollimi i seperatorit të vajit , pas mbushjes bëhet pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji deponohet në enë të posaçme dhe pastaj të dërgohen në trajtim të mëtejshëm sipas ligjit për trajtimin e materieve të rrezikshme.
- Janë vendosen kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tyre dërgohen për zbrazje në deponi regjionale.
- Janë vendosen enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lëngëta.
- Janë mbjell sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara me barë dhe drunj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

## **7.2.Masat mbrojtëse në rezervar**

- Rezervarët për lëndë djegëse të lëngtë dhe të gazta (butan, propan) janë të prodhuar sipas standardeve të caktuara dhe të vendosur po ashtu sipas standardeve.
- Në rezervarët e lëndëve djegëse të gazta, nëse rezervari vendoset mbi tokë (vendosja e rezervuarit në këtë rast është nëntokë), investitori ka vendos sistemin për sjelljen e ujit për ftohje të rezervarit në kohe me temperatura të larta.
- Të gjithë gypat ajruar të rezervarëve janë të vendosur në lartësi të sigurt.
- Është obligim permanent i punëtorëve që të kontrollojë sistemin e gypave me mekanizëm për mbushje dhe zbrazje të karburanteve nga rezervarët.

- Është obligim që rezervarët e karburanteve të kontrollohen brenda 5 viteve të para të punës për të përcjell dëmtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv, pas 5 viteve kontrolli duhet bërë për çdo dy vite.
- Për të zvogëluar mundësin e rrezikut rekomandohet që rezervari i lëndëve djegëse të gazta (butan, propan) nëse rezervari vendoset mbi tokë, të rrethohet me mur statik.

### **7.3.Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës**

- Është e obligim që mekanizmi i sistemit shpërndarës dhe rezervarët dhe janë pajisur me elementin detektues të derdhjes eventuale të karburantit
- Sistemi i gypave shpërndarës me automatë për karburant të lëngëta dhe të gazta është i siguarur që të pengohet derdhja eventuale e karburanteve
- Stacioni i karburanteve është pajisur me sistemin sekondar për mbledhjen e derdhjeve aksidentale.
- Stacioni i karburanteve është pajisur me sistemin për mbledhjen e avujve që lirohen nga karburantet.

### **7.4. Rekomandimet dhe veprime tjera për evitimin e rrezikut**

- Bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.
- Është hartuar rregullorja ku definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.
- Është ndërtuar sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- Në mënyrë permanente mirëmbahet ambienti në kompleksin e stacionit të karburanteve e posaçërisht nyje sanitare, platoja me rrethin dhe gjelbërimi rrethues.
- Është siguarur dhe janë ne disponim pajisjet doracake kundër shkëndijave
- E tërë sipërfaqja e kompleksit të stacionit të karburanteve është nën mbikëqyrje permanente dhe menaxhohen faktorët e sigurisë.

## **8. MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT**

Pas përfundimit të aktiviteteve në stacionin e karburantit, kjo varet nga pronari se sa do të vazhdojë me këtë projekt, nëse nuk vazhdohet me këtë, atëherë objektet ekzistuese duhet të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi regjionale.

Të gjitha mbetjet e mbeturinave të ngurta dhe ato të inerteve që ekzistojnë në sipërfaqet e lokacionit si shtresa e dheut të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa më kompakte, ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.

Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit gjegjësisht nga realizimi i proceseve të deponimit dhe shitjes së karburanteve. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen në rrethinë të lokalitetit dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

## **9. PËRMBLEDHJA JO TEKNIKE E INFORMATIVE**

### ***9.1. Përshkrimi i shkurtër i procesit***

*Objekti i stacionit të karburanteve Hib Petrol – në Preoc, Graçanicë është me etazhitet P+0 dhe ka strehën për shërbimin me karburant që është me etazhitet P dhe strehe të terasave gjithashtu me etazhitet P. Pamjet në figurën 7, kapitulli 4.*

*Pajimet dhe objektet që përbëjnë kompleksin e stacionit të karburanteve:*

- *Objekti i cili përmban hapësirën për administratë, hapësirën për shitjen, hapësirën për restorant me sipërfaqe rreth 700 m<sup>2</sup>*
- *Bodrumi me sipërfaqe rreth 700 m<sup>2</sup>, i destinuar si depo për deponim të materialeve përkatës, gardërobe dhe funksione tjera mbështetëse të kësaj aktiviteti.*

- *Terasa e restorantit me sipërfaqe rreth 280 m<sup>2</sup>*
- *Platoja e pompës rreth 600 m<sup>2</sup>*
- *Rezervarët e naftës (3)*
- *Rezervarët e benzinës (3)*
- *Rezervuari i gazit (1)*
- *Pompa për nafte (12) me aparatet për toçitje gjithsej (24)*
- *Pompa për benzinë (12) me aparatet për toçitje gjithsej (24)*
- *Pompa për gazë (1) me aparatet për toçitje gjithsej (2)*
- *Seperatori për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura.*

- *Hapësirat e parkingjeve , azat gjelbëruese, rrethoja e lokacionit dhe shtyllat e reklamës.*

*Për funksionimin normal të stacionit për furnizim dhe distribuim me karburant (naftë dhe benzinë), si dhe lëndë djegëse të gazta (propan-butan), janë ndërtuar edhe objekteve përcjellëse të stacionit të karburanteve si vendosa e rezervarëve për derivate dhe aparateve për toçitje edhe seperatori për ujërat, është e rregulluar – e betonuar platoja funksionale, grumbulluesit dhe sistemi për bartjen e ujërave.*

- ***Rezervarët e lëndëve djegëse të lëngëta - naftë dhe benzinë***

*Ne stacioni i karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. Preoc, Graçanicë janë vendosur gjithsej 6 rezervuar për depozitimin e naftës dhe benzinës me vëllim V = 29891 litra, 31792 litra, 48657 litra, 29643 litra, 30072 litra dhe 49165 litra, si dhe rezervari për karburant të gaztë (propan-butan) me kapacitet prej 15000 litra.*

## ***9.2.Ndikemt ne mjedise***

*Gjatë punës kontinuele të stacionit të karburanteve mund te vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga puna e automjeteve, avullimi i karburantit benzinë, avullimi i karburantit të gaztë (propan-butanit), derdhjet dhe avullimi i karburanteve të lëngët, krijohet zhurmë nga motorët e automjeteve dhe funksionimi i automatëve për dhënie të karburanteve.*

*Në mënyrë indirekte mund të vjen edhe te deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër stacionit të karburanteve.*

*Entitetet e cënueshme që potencialisht rrezikohen janë të punësuarit në stacion dhe shfrytëzuesit e shërbimeve - konsumatorët.*

- ***Ndotja e tokës***

*Toka është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vjen deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja.*

*Në fazën e shfrytëzimit të stacionit të karburanteve ndotja e dheut është e mundshme, si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platos së stacionit të karburanteve dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotëse nga ajri.*

*Kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve.*

*Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin. Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër stacionit të karburanteve varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së stacionit të karburanteve, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e stacionit të karburanteve.*

- ***Ndotja e ujit***

*Mundësia potenciale për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vjen deri te shpërthimet e rezervarëve me karburant të vendosur në tokë. Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së derivateve.*

*Gjithashtu gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vjen deri te sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e djegura motorike, i fshirjes së gomave të automjetit, i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga automjetet e amortizuara, i fundërrimeve nga atmosfera.*

*Koncentrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të reshurat atmosferike ku koncentrimet më të mëdha janë në 5- 10 minutat e para të shpëlarjes së sipërfaqes së pllatosë nga personeli apo nga të reshurat atmosferike.*

- **Ndotja e ajrit**

*Gjatë funksionimit të stacionit të karburanteve nga qarkullimet e automjeteve vjen deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet dhe nga avullimi i karburanteve.*

*Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrim të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë: CO, NO<sub>x</sub>, HxCy, SO<sub>2</sub> dhe Pb.*

*Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin ku është ndërtuar stacioni i karburanteve.*

### **9.3. Masat mjedisore**

*Stacioni i karburanteve "Hib Petrol"sh.p.k. Preoc, Graçanicë, me veprimtarinë kontinuele të sajë, sipas këtij raporti nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë parashihet që të ndermirën masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative eventuale te mjedisit jetësor.*

*Rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në stacionin e karburanteve në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.*

*Për mbrojtjen e tokës nga ndotja ne kompleksin e stacionit të karburanteve është bere sistemin për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipulative, dhe të dërgohen ne seperator për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura.*

*Separatori për vajra me kapacitet mesatare ( sipas projektit), për mes mureve ne disnivele e bën ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon ne pesetën e posaçme, ku pas mbushjes së pusetës duhet të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorve.*

*Seperator i përmbush kriteret teknike që janë te parapara me rregullore dhe normative ne fuqi.*

*Funksionon grupa septike për trajtimin e ujërave të zeza e pastaj pas gropës septike ujërat e trajtuara të dërgohen ne bunarin filtrues. Ujërat e trajtuara ne seperator dërgohen ne bunarin filtrues.*

*Përveç masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara në pasuset e mësipërme investitori ndërmerr edhe këto masa:*

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative tëra hapësirat operationale në të cilat bëhet manipulimi me karburante janë mbular me beton ose asfalt.*
- Furnizimi me ujë pije si dhe për nevoja tjera sanitare bëhetn nga sistemi i ujësjellësit, kurse furnizimi i ujit që shfrytëzohet për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, për pajimet për zjarre fikje do të bëhet nga pusi i thellë që duhet hapur nga pronari .*
- Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat të përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën në seperator.*
- Ujërat fekale nga nyjat sanitare përmes gypave dërgohen në gropën septike.*
- Rregullisht të bëhet kontrollimi i seperatorit të vajit , pas mbushjes behet pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji deponohen në enë të posaçme dhe pastaj të dërgohen në trajtim të mëtejshëm sipas ligjit për trajtimin e materieve të rrezikshme.*
- Janë vendosen kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tyre dërgohen për zbrazje në deponin regjionale, përmes kompanisë menaxhuese të mbeturinave.*
- Janë vendosen enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lëngëta.*
- Janë mbjell sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara me barë dhe drunj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.*

***Gjithashtu janë marre masat efektiva për:***

- Masat mbrojtëse në rezervar nga rreziqet eventuale*
- Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës së karburantir dhe*
- Rekomandimet tjera për evitimin e rrezikut ekcesial*

## **10. PËRFUNDIMI**

Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës në objektet e stacionit të karburanteve të cilat ndikojnë në mjedisin jetësor dhe duke i zbatuar të gjitha masat e përmendura nga kjo analizë e bërë si dhe duke pasur parasysh kapacitetin e rezervarëve për lëndë djegëse të lëngëta e të gazta dhe mjedisin rrethues të lokacionit mundë të përfundojmë se:

Funksionimi kontinual i stacionit të karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. në Preoc, Graçanicë, është analizuar dhe përshkruar mjaftueshëm lidhur me ndikimet në mjedis dhe rrezikun eventual qe paraqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit ne përgjithësi.


Andaj këto informata do te jen te mjaftueshme për Ministria e Mjedisit te marrë vendimin për pëlqimin mjedisore për stacionin e karburanteve "Hib Petrol" sh.p.k. në Preoc, Graçanicë.



**Shtojca:**

**Kosto e investimi në stacionin e karburanteve “Hib Petrol” sh.p.k. Preoc, Graçanicë:**

<b>Pajisjet</b>	<b>Çmimi €</b>
Objekti - ndritim i vrazhdë	+
Objekti - meremetimi	+
Objekti – inventari dhe mobilimi	+
Pajisjet për pompim dhe toçitje te karburantit	+
Rezervuarët e karburantit	+
Platpja e objektit	+
Infrastruktura ndihmese	+
Te tjera...	+
<b>Total (rreth)</b>	<b>196 000 €</b>



Scale = 1 : 1000



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI lëshon:

Nr. i licencës: 23/19/24

# LICENCË

Raif BYTYQI  
Dr.sc.Inxh.i mjedisit

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM- së

Data e vlefshmërisë:  
12.08.2024— 11.08.2029  
Prishtinë

